REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 90/17
Date/Datum. 30.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: ***"Trepça -Ndërrmarrje në Administrim të AKP".***

Për Aktivitetin e Prokurimit: **12997 12998-17-433-1-2-1**, Nr i brendshem: **ST 17 034 121**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me vajra dhe yndyrna (lybrifikant për makinerit e minierës)**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

NTP " BALLKAN PETROL"
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

RAKAJ
(Adresa)
FERIZAJ — *70000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*
049/113 543 — *N/A*
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

BEKIM HALITI
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
info@ballkanpetrol.com
(Adresa elektronike)

30.03.2017
(Data e parashtrimit të ankesës)

NËRMARRJA TREGTARE PRIVATE BALLKAN Petrol FERIZAJ

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

N/A
(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per kontrate ne faqen e e-prokurimit eshte publikuar me daten 27.02.2017, tenderi: "Furnizim me vajra dhe yndyrna (lybrifikant për makinerit e minierës)",me nr prokurimi 12997 12998-17-433-1-2-1, Nr i brendshem: ST 17 034 121.Afati i fundit per hapjen e tendereve ka qene 09.03.2017. Kriteret per dhenje te kontrates ka qene çmimi me i ulet.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [x] **Jo** [ ]

Procesi i hapjes se ofertave ka shkuar ne rregull dhe ka qene transparent. Nuk ka pasur verejtje.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [ ] **Jo** [x]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

Ne faqen e E-prokurimit me daten 20.03.2017 eshte publikuar njoftimi per dhenje te kontrates. Te njejten date kemi kerkuar nga A.K. qe te kemi qasje ne dokumentacionin e Operatorit Ekonomik te rekomanduar per kontrate. Me daten 21.03.2017 kemi pasur qasje ne dokumentacionin e Operatorit Ekonomik te rekomanduar per kontrate. Me daten 22.03.2017 kemi bere kerkese per rishqyrtim te vendimit per dhenje te kontrates. Me 27.03.2017 kemi pranuar nga A.K. refuzimin e kerkeses sone per rishqyrtim (te bashkangjitura me ankese).

A.K. "Trepça -Ndërrmarrje në Administrim të AKP " ne pergjegje eshte fokusuar shume ne detalet te cilat i kemi prezentuar ne kerkesen per rishqyrtim vetem si vereitje shtese, ndersa per faktet te cilat i kemi prezentuar ne kerkesen per rishqyrtim nuk kemi asnje pergjegje. Duke i krahasuar kriteret e kerkuara teknike dhe oferten e O.E. NTP "SNR" shihet shume kjart se O.E. i rekomanduar per kontrate nuk i ka plotsuar kriteret teknike te kerkuara.

Konsiderojme se AK gjat fazes se vlersimit nuk ka vepruar sipas nenit 59 paragrafi 2 pasi qe nuk i ka respektuar kerkesat qe kan qene ne specifikim teknik.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qëllimi i Ligjit
Neni 7 Barazia ne Trajtim/Jo-Diskriminimi
Neni 28 Specifikimet Teknike
Neni 59 Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi I Tendereve
Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Me rastin e qasjes ne dokumentacionin e Operatorit Ekonomik te rekomanduar per kontrate, kemi hasur ne disa shkelje te LPP-se.

Konsiderojme se A.K. "Trepça -Ndërrmarrje në Administrim të AKP" ka shkelur nenin 28 Specifikimet teknike

Arsyetim:

Konsiderojme se A.K. ka shkelur nenin 28 pasi që gjate vlersimit nuk i është përmbajtur kritereve të kërkuara në Dosje të Tenderit dhe në Specifikim teknik si ne vijim:

- Produkti 1 Vaj hidrol 68 ne specifikacionet e dhena ne DT eshte kerkuar parametri i pikes se ngrirjes te jete -27°C, ndersa OE ka ofruar -25°C.

- Produkti 3 Antifriz eshte kerkuar Antifriz koncentrat qe pas perzierjes 1:1 te kete temparaturen e ngrirjes deri ne -40°C, ndersa OE ka ofruar me temperature deri ne -37°C
- Per produktin 8 per Minieren e Stantergut eshte kerkuar yndyre me baze sapuni te kalciumit, ndersa per Minieren ne Kishnices per produktin 3 ne formularin e pershkrimit te cmimeve eshte kerkuar yndyre me baze Litiumi. Operatori Ekonomik i rekomanduar per kontrate (NTP "SNR") ka prezentuar te njejten certificate per te dy produktet edhe pse produktet qe kerkohen jane krejtesisht te ndryshem me njeri tjetrin.

Per Minieren e Kishnices produkti i kerkuar me baze Litiumi kerkohet yndyre qe i reziston temperatures nga -30°C deri +130°C, ndersa ne certifikaten e ofertuesit temperatura rezistuese eshte prej -25°C deri +65°C.
Me kete nenkuptohet se produkti i ofruar per Minieren e Kishnices nuk eshte produkt adekuat.

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.
Arsyetim:
Me larte eshte argumentuar se O.E. i rekomanduar per nenshkrim te kontrates nuk i plotson te gjitha kriteret e kerkuara ne njoftim per kontrate dhe ne dosje te tenderit.

Verejtje shtese;
- Operatori Ekonomik i rekomanduar per kontrate (NTP "SNR") ne dosjen e tij ka prezentuar certifikaten e kualitetit ISO 9001 dhe certifikaten e mjedisit ISO14001 te prodhuesit ADECO me afat te skaduar.

Deshmi tjera gjate komunikimeve me Autoritetin kontraktues jane te bashkangjitura me Ankese

Konkluzion:
Verejtjet e cekura me larte deshmojne se Operatori Ekonomik i rekomanduar per kontrate (NTP "SNR") nuk i ka permbushur kriteret e kerkuara nga AK dhe per kete kerkojme qe Ankesen tone ta kualifikoj te bazuar dhe te kerkoj nga A.K. qe te behet anulimi i njoftimit per dhenje te kontrates dhe lenda te kthehet ne **ri-vleresim**.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet materiale qe i jane shkaktuar Ballkan Petrolit ne kete rast kane nje kosto materiale te konsideruesme si pregatitja e ofertes, humbja e fitimit te planifikuar, etj.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë"
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës"
c) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve
d) një kopje të "Kerkeses se rishqyrtim"
e) nje kopje te pergjegjes se kerkese per rishqyrtim,
f) të gjitha korrespondencat me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.
g) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*